## PËR PROPOZIMIN KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË KANDIDATËVE PËR ANËTARË TË KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19/2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Propozimin Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të listës së kandidatëve të kualifikuar për anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik, sipas renditjes në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Dërgimin Kuvendit të Republikës së Shqipërisë edhe të listës së kandidatit që nuk plotëson kriteret për emërim, sipas aneksit 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**

ANEKS 1
LISTA E KANDIDATËVE TË KUALIFIKUAR, SIPAS RENDITJES ME PIKË KANDIDATË TË KUALIFIKUAR PËR ANËTAR TË KPP-së

| Nr. | Emër Mbiemër | Pikë |
|---|---|---|
| 1 | Kreshnik Tërnova (jurist) | 80 |
| 2 | Fiorent Zguro (jurist) | 78 |
| 3 | Anila Malaj (ekonomiste) | 77 |
| 4 | Melsi Beli (jurist) | 76 |
| 5 | Lindita Skeja (juriste) | 76 |
| 6 | Rezart Elmazi (Jurist) | 76 |
| 7 | Hektor Muçaj (jurist) | 73 |
| 8 | Kreshnik Bejkaj (jurist) | 72 |

| | | |
|---|---|---|
| 9 | Julian Dhima (jurist) | 71 |
| 10 | Bledar Mijo (arkitekt) | 67 |
| 11 | Gert Hekurani (financë) | 65 |
| 12 | Vildana Kabetaj (juriste) | 58 |

**KOMISIONI *AD-HOC* I VLERËSIMIT:**

**Reida Kashta (Shahollari), Enkela Dudushi, Klodjan Skënderaj**

ANEKS 2
LISTA E KANDIDATIT TË SKUALIFIKUAR

I. Kandidatë që nuk plotësojnë kushtet për t'u emëruar anëtarë të KPP-së:
1. Gjergji Mersini

## VENDIM
## Nr. 226, datë 14.4.2021

## PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË NJË ANËTARI TË KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Emërimin e znj. Evis Shurdha në detyrën e anëtarit të Komisionit Kombëtar Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, për periudhën e mbetur të mandatit, sipas përcaktimit të shkronjës "d", të pikës 3, të nenit 4, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**

## VENDIM
## Nr. 227, datë 14.4.2021

## PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË KRYEMINISTRISË, TË PRONËS ME EMËRTIMIN "GODINA E KRYEMINISTRISË", NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE 8160, DHE PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 968, DATË 25.10.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Kryeministrisë të pronës me emërtimin "Godina e Kryeministrisë", ndodhur në zonën kadastrale 8160, sipas formularit dhe planrilevimit bashkëlidhur këtij vendimi, për ushtrimin e aktivitetit administrativ.
2. Vendimi nr. 968, datë 25.10.2013, i Këshillit të Ministrave, "Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Financave te Kryeministria, të pronës nr. 1/16, në zonën kadastrale ZK 8160, me emërtimin 'Godinë e Ministrisë së Financave', me vendndodhje në bulevardin 'Dëshmorët e Kombit', nr. 1, Tiranë, për sistemimin me mjedise pune të Kryeministrisë dhe për një ndryshim në vendimin nr. 622, datë 15.9.2006, të Këshillit të Ministrave, 'Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Financave'", shfuqizohet.
3. Ngarkohen Kryeministria dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**

# 1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

**(Për inventarizimin e pronave të veçanta)**

Institucioni : Kryeministria

Bashkia: Tiranë

Fusha e përdorimit të Pronës: Administratë

Aprovoi:

Engjëll Agaçi
Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave

| Nr. Rend. | A | | | B | | | C | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Zona Kadastr. & Indeksi i Hartës | Nr. Pasurisë | Lloji i Pronës | Emri i Pronës Adresa | Sip. Totale e Pronës (m2) | Nga Sip. Totale: Sa Ndërtesë (m2) | Funksioni për të cilin përdoret Prona | Institucioni / Enti me përgjegjësi administrative | Institucioni / Enti përdorues Statusi juridik i përdorimit | Të dhëna të tjera (Shënime të veçanta) |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| 1 | 8160 | 1/16, 1/15<br>1/10, 1/12<br>1/14, 1/2 | Truall<br>Ndërtesë | **Godina e Kryeministrisë**<br>Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Nr.1<br>Tiranë | 12866.9 | 3456.6 | Administratë | Kryeministria | Kryeministria | Godinë 3 Kate + 1 kat nëntokë |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |

# PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

**PRONARI _ SHTET** **DATE _ 29.01.2021** **QELLIMI _ RREGJISTRIM**

VENDNDODHJA
BASHKIA _ TIRANE DVASHK TIRANE_JUG ZONA KADASTRALE _ 8160 NUMRI PASURISE _ 1/16, 1/15, 1/10, 1/12, 1/14, 1/2 INDEX HARTE _ TR; R-12

TE DHENAT E PASURISE
LLOJI PASURISE _ TRUALL SIP.PASURISE = 12866.9 m2 SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT _ 3456.6 m2 NUMRI KATEVE _ 3+1 kat nëntokë

## KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

X 484903 Y 4576419 X 485177 Y 4576419




X 484903 Y 4576227 X 485177 Y 4576227

**SH 1:1000**

| Nr. | ORIENTIMI | PERDORIMI | TIPI KUFIRIT | KUFITARI | ID/NIPT | SHENIME TE REALIZUESIT |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | VERI | | | 1/7 | K51726024H | |
| 2 | JUG | | | 1/45 | | |
| 3 | LINDJE | | | 1/12 | | |
| 4 | PERENDIM | | | 1/1 | | |

**REALIZOI PER IGJIU**
SPECIALIST: EDISON MEMELLI, KATJUSHA HYSENI, NAJADA DERVISHI
NENSHKRIMI ______
**KONFIRMOI**
DREJTORI: ENEA SINOIMERI
NENSHKRIMI / VULA ______
**REALIZOI PER ASHK**
SPECIALISTI ____
DVASHK ________
NENSHKRIMI ______
**KONFIRMOI**
PERGJEGJESI/DREJTORI____
NENSHKRIMI / VULA ______

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: T, Z, O
Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash;
PERCAKTIMI KUFIRIT: HK
Kode per percaktimin e kufirit:P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale;
SHENIME TE VECANTA:
Ky planrilevimi u hartua bazuar në dokumentacionit hartografik të marrë nga ASHK elektronikisht

PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET/MIRATOI

EMRI: ENGJELL AGAÇI, (SEKRETAR I PERGJITHSHEM I KESHILLIT TE MINISTRAVE )
NENSHKRIMI ______

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale

**VENDIM**
**Nr. 229, datë 14.4.2021**

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH BUXHETORE NDËRMJET PROGRAMEVE TË MIRATUARA NË BUXHETIN E VITIT 2021, PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2021, të miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, bëhet rishpërndarja e fondeve, si më poshtë vijon:

a) në programin buxhetor "Shërbimet e kujdesit parësor", në kategorinë shpenzime korrente, të pakësohet fondi prej 140 000 000 (njëqind e dyzet milionë) lekësh;

b) në programin buxhetor "Shërbimet të shëndetit publik", në kategorinë shpenzime korrente, të shtohet fondi prej 140 000 000 (njëqind e dyzet milionë) lekësh.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Instituti i Shëndetit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**

**VENDIM**
**Nr. 230, datë 14.4.2021**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE ME SHKËMBIM NOTASH TË MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR SHTESËN E FINANCIMIT PËR PROJEKTIN E MODERNIZIMIT TË ASISTENCËS SOCIALE, TË RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 53/2018**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12 e 23, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim notash të marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e financimit për projektin e modernizimit të asistencës sociale, të ratifikuar me ligjin nr. 53/2018, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BORXHIT PUBLIK DHE BASHKËRENDIMIT TË NDIHMËS SË HUAJ
DREJTORIA E BASHKËRENDIMIT DHE SIGURIMIT TË NDIHMËS SË HUAJ
SEKTORI I SIGURIMIT TË NDIHMËS SË HUAJ DHE MARRËVESHJEVE

Nr. 23754 Prot. Tiranë, më 22.12.2020

Lënda: Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale
(Huaja nr. 8841-AL)

**ZNJ. LINDA VAN GELDER**
**DREJTOR RAJONAL, BALLKANI PERËNDIMOR**
**RAJONI I EVROPËS DHE AZISË QENDRORE**
**ZYRËS SË BANKËS BOTËRORE**
**Bulevardi "Dëshmorët e 4 Shkurtit", Nr. 34, Tiranë**

E nderuar Znj. Drejtore,

I referohem marrëveshjes së Huasë të datës 5 qershor 2018 ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e financimit për Projektin e Modernizimit të Asistencës Sociale. Me qëllim finalizimin e suksesshëm të aktiviteteve të parashikuara për t'u financuar nga kjo marrëveshje dhe në përputhje me sa kërkuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet kësaj shkrese ju përcjellim kërkesën e palës shqiptare si vijon:

- Shtyrjen e afatit të mbylljes deri më 31 dhjetor 2022, Skeduli 2, Seksioni III.B.4

Kjo letër së bashku me letrën tuaj të përgjigjes do të përbëjnë marrëveshjen ndryshuese, me shkëmbim letrash të marrëveshjes së huasë nënshkruar më 5 qershor 2018, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e financimit për Projektin e Modernizimit të Asistencës Sociale.

Ky ndryshim hyn në fuqi, pasi palët të njoftojnë njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të brendshme.

Me respekt,

**MINISTËR**

**Anila Denaj**

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë, Shqipëri; Web: www.financa.gov.al

**VENDIM**
**Nr. 233, datë 14.4.2021**

## PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT DHE TË RIPARIMIT TË MJEDISEVE NË BASHKËPRONËSI OSE TË PËRBASHKËTA NË NDËRTESA (PALLAT), NË BASHKINË KURBIN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 360 194 728.38 (treqind e gjashtëdhjetë milionë e njëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e njëzet e tetë pikë tridhjetë e tetë) lekë, për financimin e rikonstruksionit ose të riparimit të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat), në Bashkinë Kurbin.

2. Fondi financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2021, dhe t'i trasferohet Bashkisë Kurbin, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kurbin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**

**VENDIM**
**Nr. 234, datë 14.4.2021**

## PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E PËRGATITJES SË SHESHEVE TË NDËRTIMIT, NË BASHKINË KURBIN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" e "iii", 16 dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 43 634 850 (dyzet e tre milionë e gjashtëqind e tridhjetë e katër mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekësh, për financimin e prishjes së njësive individuale të banimit, në Bashkinë Kurbin.

2. Fondi financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, të përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2021, dhe t'i transferohet Bashkisë Kurbin në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kurbin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**

**VENDIM**
**Nr. 235, datë 14.4.2021**

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE, NË BASHKINË KAMZË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 95 600 000 (nëntëdhjetë e pesë milionë e gjashtëqind mijë) lekë, për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para, në Bashkinë Kamzë.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2021, dhe i transferohet Bashkisë Kamzë në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**

**VENDIM**
**Nr. 236, datë 14.4.2021**

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË GODINËS SË KOPSHTIT PUBLIK DHE TË GODINËS SË BASHKISË VORË, BASHKIA VORË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË VORË SI NJËSI ZBATUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 707 302 333 (shtatëqind e shtatë milionë e treqind e dy mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të godinës së kopshtit publik dhe të godinës së Bashkisë Vorë, Bashkia Vorë, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) rindërtimi i godinës së kopshtit publik, Bashkia Vorë, në masën 88 433 787 (tetëdhjetë e tetë milionë e katërqind e tridhjetë e tre mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH;

b) rindërtimi i godinës së Bashkisë Vorë, në masën 618 868 546 (gjashtëqind e tetëmbëdhjetë milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e dyzet e gjashtë lekë) lekë pa TVSH.

2. Bashkisë Vorë, për vitin 2021, i transferohet fondi në masën 141 460 466 (njëqind e dyzet e një milionë e katërqind e gjashtëdhjetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) për rindërtimin e godinës së kopshtit publik, Bashkia Vorë, në vlerën 17 686 757 (shtatëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH;

b) për rindërtimin e godinës së Bashkisë Vorë, Bashkia Vorë, në vlerën 123 773 709 (njëqind e njëzet e tre milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e nëntë) lekë pa TVSH.

3. Caktimin e Bashkisë Vorë si njësi zbatuese për rindërtimin e godinës së kopshtit publik dhe të godinës së Bashkisë Vorë, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Vorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**

**VENDIM**
**Nr. 237, datë 14.4.2021**

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E HARTIMIT TË PROJEKTIT TË NDËRHYRJEVE REHABILITUESE/ PËRSHTATËSE TË NEVOJSHME PËR KTHIMIN E STRUKTURËS SË OBJEKTEVE QË JANË KLASIFIKUAR SI OBJEKTE ME DËMTIME TË MËDHA STRUKTURORE OSE DËMTIME SHUMË TË RËNDA JOSTRUKTURORE NË BASHKINË VORË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 31 687 604 (tridhjetë e një milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e katër) lekë, për financimin e hartimit të projektit të ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse të nevojshme për kthimin e strukturës së njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar me dëmtime të mëdha strukturore ose dëmtime shumë të rënda jostrukturore dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e shtetit për vitin 2021, dhe i transferohet në formën e transfertës së pakushtëzuar Bashkisë Vorë.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Vorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**

**VENDIM**
**Nr. 238, datë 14.4.2021**

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT TË 3 (TRI) OBJEKTEVE NË BASHKINË MIRDITË DHE CAKTIMIN E BASHKISË MIRDITË SI NJËSI ZBATUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" e "iii", 16 dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rikonstruksionit të 3 (tri) objekteve në Bashkinë Mirditë, në masën 108 617 578 (njëqind e tetë milionë e gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e

pesëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) rikonstruksionin e Qendrës Kulturore të Fëmijëve Mirditë (ish-kinemaja), në masën 25 244 079 (njëzet e pesë milionë e dyqind e dyzet e katër mijë e shtatëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH;

b) rikonstruksionin e ish-godinës së Bashkisë Mirditë, në masën 58 438 651 (pesëdhjetë e tetë milionë e katërqind e tridhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH;

c) rikonstruksionin e godinës së Muzeut Historik, Mirditë, në masën 24 934 848 (njëzet e katër milionë e nëntëqind e tridhjetë e katër mijë e tetëqind e dyzet e tetë) lekë pa TVSH.

2. Bashkisë Mirditë, për vitin 2021, i transferohet fondi në masën 21 723 515 (njëzet e një milionë e shtatëqind e njëzet e tre mijë e pesëqind e pesëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit të 3 (tri) objekteve, në Bashkinë Mirditë, në formën e transfertës së pakushtëzuar, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) rikonstruksionin e Qendrës Kulturore të Fëmijëve Mirditë (ish-kinemaja), në masën 5 048 815 (pesë milionë e dyzet e tetë mijë e tetëqind e pesëmbëdhjetë) lekë pa TVSH;

b) rikonstruksionin e ish-godinës së Bashkisë Mirditë, në masën 11 687 730 (njëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e tridhjetë) lekë pa TVSH;

c) rikonstruksionin e godinës së Muzeut Historik, Mirditë, në masën 4 986 969 (katër milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.

3. Caktimin e Bashkisë Mirditë si njësi zbatuese për financimin e rikonstruksionit të 3 (tri) objekteve, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Mirditë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**

## VENDIM
## Nr. 239, datë 14.4.2021

## PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 980, DATË 2.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIMIT, ZBATIMIT TË PUNIMEVE, MBIKËQYRJES DHE KOLAUDIMIT TË QENDRËS SË SHËRBIMEVE DHE ADMINISTRIMIT TË MJETEVE TË TRANSPORTIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" e "iii", 16, dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 980, datë 2.12.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) kudo në vendim, fjalët "... Agjencia e Blerjeve të Përqendruara ..." zëvendësohen me "... Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ...";

b) pika 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

"4. Fondi i përcaktuar në pikën 3, të këtij vendimi, i shtohet Ministrisë së Brendshme, në programin "Policia e Shtetit".".

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**

## VENDIM
## Nr. 240, datë 14.4.2021

## PËR KALIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË SHIJAK TË OBJEKTIT ARSIMOR, SHKOLLA E MESME E BASHKUAR “KAJO KARAFILI”, BASHKIA SHIJAK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 21, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi të Bashkisë Shijak të objektit arsimor shkolla e mesme e bashkuar “Kajo Karafili”, Bashkia Shijak, sipas listës së inventarit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Shijak për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**

TË DHËNAT E PËRMBLEDHURA PËR OBJEKTET ARSIMORE (TABELA NR. 1)

| Nr. | Qarku | Bashkia | Njësia Administrative | Niveli | Emërtimi | Tipologjia e ndërhyrjes | Financimi i ndërtimit | Sipërfaqe (m²) | Vlera e projektidesë | Vlera e projektit te zbatimit dhe ndërtimit | Vlera e mbikëqyrësit | Vlera e kolaudimit | Vlera totale e objektit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 17 | Bashkia Shijak | Shijak | Maminas | E mesme | Kajo Karafili | Ndërtim | Buxhet GoA | 2,895.0 | 644,700.00 | 123,500,562.00 | 1,313,298.00 | 118,389.22 | 125,576,949.22 |
| **TOTAL** | | | | | | | | **2,895.0** | **644,700.0** | **123,500,562.0** | **1,313,298.0** | **118,389.2** | **125,576,949.2** |

## URDHËR
## Nr. 162, datë 12.4.2021

## PËR NDALIMIN E PESHKIMIT NË LIQENET E OHRIT, PRESPËS, FIERZËS, ULZËS DHE SHKOPETIT

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, pikës 1, të nenit 13 të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e peshkimit, me çfarëdolloj mjeti dhe metode gjuetie, si dhe mbajtjen në bord, tranzitimin në barkë, zbarkimin e qëllimtë dhe hedhjen në treg ose për konsum të të gjitha llojeve të peshqve në liqenet e Ohrit, Prespës, Fierzës, Ulzës e Shkopetit dhe, konkretisht:

- Për gjuhcën (cironka), prej 20 prillit deri më 20 korrik 2021, në liqenin e Ohrit, dhe prej 1 prillit deri më 31 korrik 2021, për liqenin e Prespës, Fierzës, Ulzës e Shkopetit.
- Për krapin, prej 20 prillit deri më 20 korrik 202,1 në liqenin e Ohrit, dhe prej 1 prillit deri më 1 korrik 2021, për liqenin e Prespës, Fierzës, Ulzës e Shkopetit.

2. Për periudhën 20.7.2021 deri më 20.8.2021, ndalimin e peshkimit me rrjeta në fashën bregliqenore prej 300 ml nga bregu për liqenin e Ohrit dhe për periudhën 1.8.2021 deri më 31.8.2021, ndalimin e peshkimit me rrjeta në fashën bregliqenore prej 150 ml nga bregu për liqenin e Prespës, Fierzës, Ulzës e Shkopetit.

3. Vendbazimi i varkave të peshkimit do të jetë në pikat e caktuara nga OMP-të përkatëse.

4. Për zbatimin e këtij urdhri, të hartohet një plan i përbashkët operativ veprimi nga Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës në koordinim me OMP-të përkatëse që ushtrojnë aktivitet peshkimi në këto liqene.

5. OMP-të të marrin të gjitha masat e zhvendosjes së objekteve ku peshqit kanë lëshuar vezët, në rastet e rënies së nivelit të ujit në këto liqene.

6. Ngarkohet Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, në vartësi të së cilës është Sektori i Kontrollit të Peshkimit, Organizatat e Menaxhimit të Peshkimit të liqenit të Ohrit, Prespës, Fierzës, Ulzës e Shkopetit, që të monitorojnë zbatimin e planit operativ të veprimit për zbatimin e këtij urdhri, duke bashkëpunuar me strukturat e qeverisjes vendore, Drejtorinë e Policisë së Rendit dhe atë Kufitare të qarqeve përkatëse dhe Autoritetin Kombëtar të Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
**Milva Ekonomi**

**VENDIM**
*(i shkurtuar)*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr. 29 (79), datë 21.1.2021, vendosi vërtetimin e faktit juridik, se shtetasi Mondi Lili Vangjelina Stambolliu, i datëlindjes 31.3.1967, lindur në Lushnjë dhe banues në Goriçaj, Lushnjë, ka vdekur në datën 19.4.1996 në Greqi, si rezultat i një aksidenti automobilistik.

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2021 - Numri: 60
Datë: 2021/04/16 13:57:32
2102bc02-c739-46e8-bd32-95bd61724391

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)*

| | |
|---|---|
| | Formati 61x86/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 80 lekë